

Aspekte të ndryshme të durimit

Nga Uddet es-Sabirin ue Dhakiret esh-Shakiriin i Imam ibn Kajjim el-Xheuzije

Durimi mund të jetë dy llojesh: fizik dhe psikologjik, dhe të dy llojet mund të jenë me apo pa zgjedhje, siç vijon:

- 1- durimi fizik me zgjedhje, siç është kryerja e vullnetshme e punëve të rënda;
- 2- durimi fizik pa zgjedhje, siç është të qenit i duruar gjatë sëmundjes, rrahjes dhe të nxehtit si edhe të ftohtit të madh;
- 3- durimi psikologjik me zgjedhje, siç është përmbajtja nga gjëra të cilat konsiderohen të gabuara, si nga Sheriati, ashtu edhe nga arsyeja e shëndoshë;
- 4- durimi psikologjik pa zgjedhje, siç është të qenit i duruar në një ndarje të detyruar nga dikush që ti e do.

Shkallë të ndryshme të durimit

Siç u përmend më lart, durimi është dy llojesh: me ose pa zgjedhje. Durimi me zgjedhje është i një shkalle më të lartë sesa durimi pa zgjedhje, meqë këtë të fundit e gjejmë tek të gjithë njerëzit, por i pari nuk është i arritshëm nga të gjithë. Ndaj, durimi i Jusufit në kundërshtimin e gruas së Azizit dhe durimi i tij në mbartjen e dënimit të mëpasshëm, është i një shkalle më të lartë sesa durimi i tij ndaj veprimeve të vëllezërve të vet, kur ata e hodhën në bunar, e ndanë nga babai i tij dhe e shiten si një rob. Ky durim më i lartë, i vullnetshëm, është durim i peygamberëve, i Ibrahimit, i Musasë, i Nuhut, i Isasë dhe i vulës së peygamberëve, Muhamedit [salallahu alejhi ue selam]. Durimi i tyre ka qenë në thirrjen e njerëzve për te Allahu dhe përpjekja kundër armiqve të Allahut.

Durimi njerëzor dhe durimi i kafshëve

Këto katër lloje të durimit vlejné vetëm për qeniet njerëzore. Kafshët marrin pjesë vetëm në dy llojet e para të durimit, në të cilat s'ka zgjedhje, kurse njeriu dallohet me durimin në të cilin ka zgjedhje. Mirëpo, shumë njerëz kanë vetëm llojet e durimit që kanë edhe kafshët, domethënë, durimin pa zgjedhje.

Durimi i xhinëve

Xhinët, po ashtu, kanë cilësinë e durimit, si njerëzit, meqë ata janë përgjegjës për veprimet e tyre sikurse njerëzit. Atyre u nevojitet durimi për të përmbushur detyrimet ndaj Allahut sikurse edhe neve. Dikush mund të pyet: A janë ata përgjegjës në të njëjtën mënyrë sikurse ne, apo ndryshe? Përgjigja është se, për sa u përket çështjeve emocionale dhe ndjenjave, ata janë përgjegjës sikurse ne, dhe ndajnë detyrimin e dashjes për hir të Allahut dhe urrejtjes për hir të Tijin, të besimit, të marrjes për shokë besimtarët dhe armiqtë e besimit të mosbesimtarëve, etj. Por,

për sa u përket çështjeve fizike, si gusli, abdesi, pastrimi pas kryerjes së nevojës dhe të bërit synet, ata nuk janë si ne. Në lidhje me këtë, detyrimet e tyre janë në përputhje me mënyrën e krijimit të tyre.

Durimi i engjëjve

Një tjetër pyetje që mund të parashtrohet është: A kanë engjëjt durim? Përgjigja është se engjëjt nuk provohen me teka e dëshira që bien në kundërshtim me arsyen dhe dijen e tyre. Për ta adhurimi dhe bindja ndaj Allahut janë sikurse frymëmarrja për ne. Ndaj, engjëjve nuk u duhet durimi, sepse durimi është i nevojshëm atëherë kur personi ka motive kontradiktore, fe dhe arsye të kundërt me teka e dëshira. Mirëpo, engjëjt mund të kenë një lloj durimi, i cili u shkon atyre dhe i bënë ata të qëndrueshëm në kryerjen e asaj për çfarë janë krijuar.

Durimi i njeriut

Nëse durimi i njeriut është më i fortë se tekat dhe dëshirat e tij, atëherë ai është si një engjëll; nëse tekat e dëshirat e tyre janë më të forta se durimi i tij, atëherë ai është si një dreq; nëse dëshira e tij për ushqim, për pije dhe për marrëdhënie seksuale është më e madhe se durimi i tij, atëherë ai s'është më i mirë se një kafshë.

Katadeh ka thënë: "Allahu i ka krijuar engjëjt me arsye dhe pa dëshira, kafshët i ka krijuar me dëshira dhe pa arsye, dhe njeriun e ka krijuar me të dyja: me arsye dhe me dëshira".

Kështu, nëse arsyeja e njeriut është më e fortë se dëshira e tij, ai është si një engjëll; nëse dëshirat e tij janë më të forta se arsyeja e tij, ai është si një kafshë. Foshnja e vogël ka vetëm dëshirën për ushqim, kur ka nevojë për të, dhe durimi i saj është si i kafshës. Derisa ta mbërrijë moshën kur mund t'i dallojë gjërat, ajo s'ka zgjedhje. Kur të jetë rritur pak më shumë dhe të ketë zhvilluar ndjenjën për lojë, do të zhvillohet edhe durimi me zgjedhje. Njëkohësisht, fuqia e tij e të gjykuarit, po ashtu, është në zhvillim e sipër, por mes vjetëve kur ai mund ta dallojë të keqen nga e mira, në kohën e pubertetit, e gjithë çfarë ai mund të shohë është interesi i tij në këto botë dhe çfarë mund ta përkeqësojë jetën apo ta bëjë atë më të bukur. Kjo pikëpamje e kufizuar do të mbetet, derisa të jetë i udhëzuar nga Allahu. Pastaj, ai do të ketë një fotografi të plotë dhe do të fillojë të mendojë për interesin e vet, si në këtë botë, ashtu edhe në tjetrën. Ai do të vetëdijësohet se ku mund të çojnë veprime të caktuara, dhe do të përgatitet për një luftim të gjatë me dëshirat veta dhe me prirjet e natyrshme.

Shkallë të ndryshme të durimit

Ky lloj durimi, i cili ka të bëjë me kundërshtimin ndaj tekave dhe dëshirave, mund të gradohet sipas asaj se sa i forte dhe efektiv jeni. Në lidhje me këtë, ka tri shkallë të durimit:

Motivi i fesë është më i forti në kontrollimin dhe mposhtjen e tekave dhe të dëshirave. Kjo shkallë e kontrollit mund të arrihet vetëm nëpërmjet durimit të vazhdueshëm, dhe ata që e

mbërrijnë këtë shkallë, janë fitimtarë në këtë botë dhe në jetën e përtejme. Ata janë të cilët **"Thonë: 'Zoti ynë është Allahu'"** [Fussilet, 30]. Këta janë ata, që, në momentin e vdekjes, engjëjt u thonë:

"Mos ki frikë e as mos u pikëllo! Prano përgëzimet për Kopshtin [e lumturisë], i cili të është premtuar. Ne jemi mbrojtësit tu në këtë jetë dhe në jetën e përtejme". [Fussilet, 30-31]

Ata janë të cilët gëzojnë shoqërimin e Allahut dhe japin mundin në rrugën e Allahut. Ata janë të cilët Allahu i ka udhëzuar, veças të tjerëve.

Kur mbizotërojnë tekat dhe dëshirat, motivi fetar shkatërrohet. Personi i dënuar do t'i dorëzohet plotësisht shejtanit dhe forcave të tij, të cilat do ta udhëheqin për kudo që të duan. Marrëdhëniet e tij me ta do të jenë në një rën nga dy mundësitë: ose ai do të bëhet pasues i tyre dhe një ushtar në armatën e tyre, që është rasti i personit të dobët, ose shejtani do të bëhet një armë për të dhe një ushtar i tij, që është rasti i personit të fortë, i cili rebelohet kundër Allahut. Këta njerëz i ka kapluar mjerimi, sepse parapëlqyen këtë botë ndaj tjetrës. Arsyeja kryesore për fatin e tyre të mjeruar është se ata e humbën durimin. Cilësitë më të spikatura të këtyre njerëzve janë rrena dhe mashtrimi, dhe se ia bëjnë vetes qejfin dhe mahniten me veten e tyre, si dhe parapëlqejnë përfitimet e kësaj bote ndaj përfitimeve të përherëshme në jetën e përtejme. Këta janë njerëzit për të cilët peygamberi [salallahu alejhi ue selam] ka thënë:

"Njeriu i paaftë është ai që ndjek tekat e dëshirat e veta dhe ia bën vetes qejfin".

Këta njerëz të mjerë janë disa llojesh. Disa prej tyre i shpallin luftë Allahut dhe të dërguarit të Tij, duke u përpjekur të shkatërrojnë atë çfarë solli peygamberi [salallahu alejhi ue selam], duke i larguar njerëzit nga rruga e Allahut dhe duke bërë çrregullime në tokë. Disa janë të interesuar vetëm për leverdinë që kanë në këtë botë. Disa janë hipokritë dyfytirësh, të cilët përpiqen t'i hyjnë në zemër secilit dhe të përfitojnë nga çdo situatë. Disa janë të shturur dhe i tërë jetën ia kushtojnë përmbushjeve të kënaqësive fizike. Disa, nëse paralajmërohen, thonë se me dëshirë do të pendoheshin, por e shohin këtë si të vështirë dhe arsyetohen se s'kanë zgjedhje. Disa thonë se Allahu nuk ka nevojë për namazin dhe për agjërimin e tyre, se s'do të arrijnë shpëtimin nëpërmjet veprave të tyre, dhe se do të mbështeten në faktin se Allahu është i mëshirshëm. Disa prej tyre pohojnë se përmbajtja nga kryerja e punëve të këqija do të thotë t'i bësh hile faljes së Allahut. Disa do të thonë: "Çfarë dobie mund të kenë punët e mira pas të gjitha atyre veprimeve të këqija që kam bërë? Çfarë mund t'i ndihmojë njeriut që po mbytet, nëse gishtërinjtë e tij janë mbi ujë ndërsa pjesa tjetër e trupit e fundosur?" Disa thonë se do të pendohen, kur të afrohet vdekja...

Aq shumë arsytetime! Të gjitha këto, nga shkakut se tekat dhe dëshirat kontrollojnë arsyen e tyre, dhe ata përdorin arsyen e tyre për të gjetur mënyra të përmbushjes së këtyre dëshirave. Arsyeja e tyre është zënë rob nga shejtani dhe shfrytëzohet për t'i arritur qëllimet e tij të liga, mu siç mund të keqtrajtohen të burgosurit muslimanë nga mosbesimtarët dhe të shtrëngohen për të mbajtur derra, për të bërë verë apo për të mbartur kryqin. Njeriu që ndrydh arsyen e vet dhe e

vë nën kontroll të armikut [shejtanit], është si ai që e ndalon një musliman dhe ia dorëzon atë mosbesimtarëve për ta burgosur atë.

Mes motivit fetar dhe arsyes, motivit të tekave dhe atij të dëshirave zhvillohet një luftë e tërbuar. Herë dominon njëra, herë tjetra. Modeli i fitoreve për të dyja anët ndryshon. Kështu qëndron puna me shumicën e besimtarëve, të cilët përziejnë veprat e këqija me veprat e mira.

Fati përfundimtar i njerëzve në jetën e përtejme do t'i përgjigjet njërës nga tri situatat e përvijuara më lart. Disa njerëz do të hyjnë në parajsë dhe kurrë s'do të hyjnë në Zjarr, disa do të hyjnë në Zjarr dhe kurrë s'do të hyjnë në parajsë, dhe disa do të hyjnë në Zjarr për një kohë përpara se të pranohen në parajsë.

Forcat e ndryshme të durimit

Disa njerëz s'mund të kenë durim pa u përpjekur shumë dhe pa u përball me vështirësi. Të tjerët kanë aftësi të jenë lehtë të duruar. Lloji i parë është si një njeri që kacafytet me një njeri të fortë dhe s'mund ta mposhtë atë as me përpjekjen më të madhe. Lloji i dytë është si një njeri që kacafytet me një njeri të dobët dhe lehtë e mund atë. E këtillë është lufta mes ushtarëve të e-Rahmanit dhe ushtarëve të shejtanit. Kushdo që mposhtë ushtarët e shejtanit, mund ta mposhtë vetë shejtanin. Abdullah ibn Mes'udi ka transmetuar:

"Një njeri u kacafyt me një xhin dhe e mposhti atë, pastaj e pyeti: 'Përse je kaq i vogël e i dobët?' 'Në krahasim me xhinët e tjerë, unë jam shumë i madh dhe i fortë' – u përgjigj xhini. Dikush pyeti: 'A ishte ky njeri Umeri?' dhe ai iu përgjigj: 'E kush tjetër?!'"

Disa nga sahabët kanë thënë:

"Besimtari e fshikullon shejtanin sikurse personi që fshikullon devenë e vet në udhëtim".

Ibn ebi Dunja ka transmetuar nga disa selefë se një shejtan u takua me një tjetër dhe e pyeti përse ishte aq i imët. Shejtani tjetër u përgjigj: "Sepse jam me një njeri që, kur han, e përmend Allahun, kështu që s'mund të ha me të. Kur pi, ai përmend emrin e Allahut, kështu që s'mund të pi me të. Kur hyn në shtëpinë e vet, ai përmend emrin e Allahut, kështu që mbetem jashtë".

Shejtani i parë tha: "Unë jam me një njeri që, kur han, nuk e përmend emrin e Allahut, kështu që unë ha me të. Kur pi, ai nuk e përmend emrin e Allahut, kështu që unë pi me të. Kur hyn në shtëpinë e vet, nuk e përmend emrin e Allahut, kështu që hyj me të".

Kështu, kushdo që e zhvillon shprehinë e durimit, ia kanë frikën armiqtë e tij; kushdo që e ka të vështirë të jetë i duruar, është në rrezik, sepse armiku i tij është i gatshëm ta sulmojë dhe ta dëmtojë atë.

Kur është i nevojshëm durimi

Durimi është i nevojshëm në sferat e jetës në vijim:

- 1- në adhurimin ndaj Allahut dhe në zbatimin e urdhrave të Tij
- 2- në përmbajtjen nga veprat e këqija
- 3- në pranimin e caktimit dhe vendimit të Allahut [*kadasë* dhe *kaderit*]. Kjo është këshilla që iu dha Lukmanit, kur ai i tha të birit të vet:

"O biri im, fal namazin, urdhëro për të mirë dhe ndalo nga e keqja, dhe mbart me durim çfarëdo që të godet. Sepse kjo është vendosmëri [e synimit] në çështjet". [Lukman, 17]

Urdhërimi për të mirën do të thotë të bësh mirë edhe vetë, dhe ndalimi nga e keqja do të thotë të mos e bësh atë vetë.

Durimi në adhurimin ndaj Allahut

Durimi në adhurimin ndaj Allahut dhe në zbatimin e instruksioneve të Tij do të thotë të bësh aktet e urdhëruara të adhurimit rregullisht dhe që kjo të bëhet sinqerisht, me dije. Adhurimi i parregullt nuk vlen asgjë. Edhe nëse adhurimi bëhet rregullisht, ka dy rreziqe. Së pari: rrezikojmë ta humbasim sinqeritetin, nëse motivi për faljen e namazeve s'është kënaqja e Allahut dhe afrimi ndaj Tij. Kështu, për të mbrojtur adhurimin tonë, duhet të sigurohemi të jemi të sinqertë. Së dyti: duhet të sigurohemi të mos devijojmë kurrë nga shtegu i pejgamberit [salallahu alejhi ue selam]. Pra, duhet të sigurohemi që adhurimi ynë të bëhet në përputhje me Sunetin.

Durimi në përmbajtjen nga veprimi i keq

Ky lloj durimi mund të arrihet nëpërmjet frikës nga dënimi i cili e pason veprimin e gabuar, apo nëpërmjet ndjenjës së *heja* [turpit] përpara Allahut për shfrytëzimin e bekimeve të Tij në bërjen e veprave të këqija. Kjo ndjenjë turpi përpara Allahut mund të forcohet nëpërmjet mësimin më shumë rreth Allahut dhe mësimin më shumë rreth emrave dhe cilësive të Tij. Turpi është një cilësi e njerëzve fisnikë, me cilësi të mira. Kështu, personi që përmbahet nga veprimi i keq, për shkak të turpit, është më i mirë sesa ai që përmbahet për shkak të frikës. Turpi tregon se një person është i vëmendshëm për Allahun dhe për fuqinë e Tij. Personi që tmerrohet me frikë nga Allahu, mendimet i ka të përqendruara në dënimin. Interesi kryesor i personit të frikësuar është vetja e tij dhe si ta shpëtojë veten nga dënimi, kurse interesi kryesor i personit të turpshëm është Allahu dhe lavdia e Tij. Të dy kanë arritur pozitën e imanit, por personi i turpshëm ka arritur ihsanin, një pozitë më të lartë të imanit, në të cilën ai sillet sikur ta shihte Allahun dhe kështu zemra e tij është e mbushur me turp [*heja*].

Arsyeja përse është kaq e rëndësishme për një besimtar të përmbahet nga veprimi i keq është se ai duhet ta mbrojë imanin e tij, meqë veprimi i keq e zvogëlon imanin apo e shuan atë. Pejgamberi [salallahu alejhi ue selam]:

"Kur kurorëshkelësi bën kurvëri, ai s'është besimtar; kur pijetari pi alkool, ai s'është besimtar dhe, kur hajni vjedh, ai s'është besimtar. Besimtari duhet të përmbahet nga shumë gjëra të lejueshme, nëse ato mund të çojnë tek e ndaluara".

Durimi gjatë kohërave të vështira dhe provave

Durimi gjatë vështirësive mund të arrihet nga:

1- të menduarit për shpërblimin e mirë që do të ndodhë. Sa më shumë që të besosh në shpërblimin që të pret, aq më lehtë është të jesh i duruar. Po të mos ishte pritja për shpërblimet, asnjë synim që ka të bëjë me këtë jetë apo me jetën e përtejme s'do të arrihej. Natyra njerëzore e do kënaqjen e çastit, por arsyeja dhe matura na bëjnë të mendojmë për pasojat afatgjate, çka na ndihmon ta forcojmë durimin tonë në qëndrimin ndaj gjërave me të cilat përballemi, qoftë kur kemi zgjedhje apo jo.

2- Pritja dhe shpresa për një kohë të rehatshme. Kjo shpresë, në vetvete, ofron një ngushëllim të menjëhershëm.

3- Të menduarit rreth bekimeve të panumërta të Allahut. Kur kuptojmë se s'mund të numërojmë bekimet e Allahut, na lehtësohet ushtrimi i durimit përballë vështirësive të tanishme, sepse telashet e tanishme, në krahasim me oqeanin e bekimeve të Allahut, janë si një pikë shiu.

4- Të menduarit për bekimet e mëhershme të Allahut. Kjo do të na e kujtojë kujdesin e Allahut dhe do të na i forcojë shpresat dhe pritjet për kohët e rehatshme që do të vijnë.